



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 04/L-016**

**PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË**

**KREU I**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kuadrit të nevojshëm ligjor dhe institucional për rregullimin e fushës së efiçencës së energjisë.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Ky ligj rregullon çështjen e efiçencës së energjisë, përgatitjen, dhe aprovimin e planeve të efiçencës së energjisë dhe raportimin për to, përcaktimin e roleve, detyrave dhe përgjegjësiive të institucioneve si dhe adresimin e detyrimeve që burojnë nga Traktati i Komunitetit të Energjisë lidhur me efiçencën e energjisë.

### **Neni 3** **Përkufizimet**

#### 1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Ministria** - Ministria e Republikës së Kosovës përgjegjëse për sektorin e energjisë.

1.2. **Efiçienca e energjisë** - raporti në mes të vlerës së energjisë së përfituar, prodhimit dhe performacës ndaj vlerës së sasisë së energjisë së konsumuar për këtë destinim.

1.3. **Përmirësimi i efiçencës së energjisë** - ngritja e nivelit të efiçencës së energjisë te përdoruesit fundorë të energjisë si rezultat i ndryshimeve teknologjike, sjelljes dhe ndryshimeve ekonomike.

1.4. **Kursimet e energjisë** - sasia e energjisë së kursyer, e përcaktuar nëpërmjet matjes ose vlerësimit të përafërt të konsumit para dhe pas zbatimit të një apo më shumë masave të përmirësimit të efiçencës së energjisë, duke siguruar normalizim të kushteve të jashtme, të cilat kanë ndikim në konsumin e energjisë;

1.5. **Programet për përmirësimin e efiçencës së energjisë** - aktivitetet që përqendrohen në grupet e konsumatorëve fundor dhe të cilat zakonisht çojnë në përmirësim të verifikueshëm dhe të matshëm, apo përafërsisht të matshëm të efiçencës së energjisë;

1.6. **Masat për përmirësimin e efiçencës së energjisë** - të gjitha veprimet që rezultojnë në përmirësim të verifikueshëm, të matshëm, apo përafërsisht të matshëm të efiçencës së energjisë;

1.7. **Plani i Kosovës për efiçencën e energjisë** - dokumenti i aprovuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili përshkruan qëllimin e promovimit të efiçencës së energjisë, caqet indikative të kursimit të energjisë, politikat e efiçencës, planifikimin, programet kyçe, masat, koston dhe stimulimin.

1.8. **Plani Komunal për efiçencën e energjisë** – dokumenti i aprovuar nga Kuvendi Komunal, i përgatitur në përputhje me Planin e Kosovës për efiçencën e energjisë.

1.9. **Auditimi i energjisë** - është procedurë sistematike, e cila ofron:

1.9.1. njohuri adekuate mbi gjendjen ekzistuese të konsumit të energjisë së ndonjë ndërtesë, ose grupi ndërtesash, të një objekti industrial, impianti, të një shërbimi publik ose privat;

1.9.2. identifikimin e mundësive të kursimit të energjisë me kosto efektive, dhe

1.9.3. raportimin e rezultateve.

1.10. **Auditori i energjisë** - personi fizik apo juridik i licencuar për auditim të energjisë.

1.11. **Agjencia e Kosovës për efikasitetin e energjisë – AKEE** - institucioni ekzekutiv i themeluar me këtë ligj.

1.12. **Këshilli certifikues i auditorëve dhe menaxherëve të energjisë** - organi i themeluar nga Ministri i cili menaxhon sistemin e certifikimit të auditorëve dhe menaxherëve të energjisë.

1.13. **Traktati i komunitetit të energjisë** - Marrëveshje ndërkombëtare, nënshkruar në vitin 2005 nga vendet e Evropës juglindore për çështjen e energjisë, përkatësisht për sigurinë e furnizimit me energji dhe tregun e energjisë, investimeve, zhvillimit ekonomik dhe stabilitetin social.

1.14. **Komuniteti i energjisë** - përbëhet prej shteteve nënshkruese të Marrëveshjes për themelimin e komunitetit të energjisë.

1.15. **Këshilli ministror i komunitetit të energjisë** - është organi më i lartë vendimmarrës i Komunitetit të Energjisë.

1.16. **Sekretariati i komunitetit të energjisë** - është organi më i lartë ekzekutiv i komunitetit të energjisë.

## **KREU II DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE**

### **Neni 4 Ministria**

1. Ministria ka për detyrë të:

1.1 themelojë, Agjencinë e Kosovës për efikasitetin e energjisë-AKEE;

1.2 krijojë Komisionin për certifikim të auditorëve dhe menaxherëve të energjisë, detyrat dhe përgjegjësitë e të cilit përcaktohen me akt nënligjor;

1.3 zhvillojë politikën e efikasitetit të energjisë, si pjesë e strategjisë së Kosovës për Energji;

1.4 shqyrtojë dhe dërgojë për miratim në Qeveri planin e Kosovës për eficiencyn e energjisë ne përputhje me Direktiven 2006/32/EC, të rishikuar në periudhën tre (3) vjeçare dhe të raportojë në Qeveri, çdo tre (3) vjet për zbatimin e tij;

1.5 hartojë Planin e Kosovës për eficiencyn e energjisë, në pajtim me Direktivën 2006/32/EC.

2. Plani i Kosovës për eficiencyn e energjisë si dhe raporti i zbatimit të tij dërgohen në Sekretariatit e komunitetit te energjisë sipas kërkesave të përcaktuara nga ky Sekretariat.

## **Neni 5**

### **Agjencia e Kosovës për eficiencyn të energjisë**

1. Agjencia e Kosovës për eficiencyn e energjisë(AKEE) është institucion ekzekutiv në kuadër të Ministrisë. Selia e AKEE është në Prishtinë.

2. AKEE financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

3. AKEE udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv, i cili zgjidhet në përputhje me Ligjin për shërbimin civil.

4. Organizimi i brendshëm i AKEE rregullohet me akt nënligjor te aprovuar nga Ministri.

## **Neni 6**

### **Detyrat e Agjencisë së Kosovës për eficiencyn të energjisë**

1. Agjencia e Kosovës për eficiencyn e energjisë është përgjegjëse:

1.1. t'i propozojë ministrit politikat për promovimin e eficiencys së energjisë;

1.2. ta zhvillojë dhe mirëmbajë bazën e të dhënave për eficiencyn e energjisë;

1.3. ta zhvillojë sistemin e monitorimit të implementimit të Planit të Kosovës për eficiencyn e energjisë dhe përmbushjes të caqeve indikative për kursim të energjisë;

1.4. ti propozojë ministrit Planin e Kosovës për eficiencyn e energjisë;

1.5. ta përgatisë Raportin e progresit të Zbatimit të Planit të Kosovës për eficiencyn e energjisë;

1.6. t'i udhëzojë dhe mbështesë komunat për përgatitjen e planeve komunale për eficiencyn e energjisë dhe raporteve të tyre të progresit;

- 1.7. ta promovojë eficiencyn e energjisë nëpërmjet fushatave ndërgjegjëse;
- 1.8. të paraqesë rekomandime për përmirësimet e nevojshme në planet e eficiencys së energjisë, të nivelit qendrorë dhe komunal;
- 1.9. ta përgatisë për ministrin raportin vjetor të punës së saj;
- 1.10. të bashkëpunojë me ministrinë dhe institucionet e tjera relevante në implementimin e planeve të eficiencys së energjisë;
- 1.11. ta mbështesë pjesëmarrjen e palëve të interesuara në ndërmarrjen e iniciativave për eficiencyn e energjisë;
- 1.12. ta propozojë në ministri përmirësimin dhe plotësimin e bazës ligjore dhe rregullative në fushën e eficiencys së energjisë, me qëllim të harmonizimit të tyre me standardet relevante evropiane për eficiencyn e energjisë;
- 1.13. t'i mbështesë zyrat komunale të energjisë për çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe promovimin e eficiencys së energjisë dhe implementimin e programeve të ndryshme të eficiencys së energjisë në nivel komunal;
- 1.14. të promovojë aktivitetet informative dhe edukative në fushën e eficiencys së energjisë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë, ndërtimin dhe arsimin.

## **Neni 7**

### **Themelimi dhe funksionimi i Komisionit për Certifikim të auditorëve dhe menaxherëve të energjisë**

1. Ministria themelon Komisionin për Certifikim të auditorëve dhe menaxherëve të energjisë, si dhe përcakton organizimin, përgjegjësitë dhe detyrat e tij me akt nënligjor.
2. Ministria është përgjegjëse për zhvillimin institucional dhe mbarëvajtjen e procesit të auditimit të energjisë, për një periudhë tre (3) vjeçare, prej datës së themelimit të Komisionit për certifikim të auditorëve dhe menaxherëve të energjisë. Pas kësaj periudhe sipas një akti të veçantë nënligjor të miratuar nga Ministri, procesi i auditimit zhvillohet nga sektori jopublik.

## **KREU III PLANET PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË**

### **Neni 8 Plani i Kosovës për efiçencën e energjisë**

1. Plani i Kosovës për efiçencën e energjisë është dokument i detyrueshëm për zbatim, i cili përgatitet nga AKEE, në përputhje me kërkesat e Direktivës 2006/32/EC dhe ato të Sekretariatit të Komunitetit të energjisë dhe i dërgohet për shqyrtim Ministrit i cili e dërgon për miratim në Qeveri.
2. Raporti i zbatimit të planit të Kosovës për efiçencën e energjisë përgatitet nga AKEE dhe i dërgohet për shqyrtim Ministrit i cili e dërgon atë për miratim në Qeveri. Dërgimi i Raportit në sekretariatit të Komunitetit të energjisë bëhet sipas kërkesave të sekretariatit.

### **Neni 9 Plani Komunal për efiçencën e energjisë**

1. Zyrat komunale për energji përgatisin planin komunal për efiçencë të energjisë sipas udhëzimeve nga AKEE-ja.
2. Plani komunal për efiçencën e energjisë miratohet nga Kuvendi komunal dhe i dërgohet AKEE-së.
3. Zyrat komunale për energji përgatisin Raportin e progresit të zbatimit të planit komunal për efiçencë të energjisë sipas udhëzimeve nga AKEE-ja.
4. Raporti i progresit të zbatimit të planit Komunal për efiçencën e energjisë miratohet nga Kuvendi komunal dhe dërgohet në AKEE.
5. Procedurat dhe afatet e përgatitjes së planeve komunale dhe raportimi për zbatimin e tyre përcaktohen në akt nënligjor të miratuar nga ministri.

## **KREU IV MASAT E EFIÇIENCËS SË ENERGJISË**

### **Neni 10 Menaxhimi i energjisë në sektorin publik**

1. Sektori publik obligohet që ta shfrytëzojë energjinë në mënyrë efiçente.

2. Për zbatimin e paragrafit 1. të këtij neni, Qeveria, me propozim të Ministrisë, nxjerrë aktet tjera nënligjore të nevojshme.

### **Neni 11** **Financimi i Masave për eficiencën e energjisë**

1. Për mbështetjen e masave të përcaktuara në Planin e Kosovës për eficiencën e energjisë, Ministria duhet të:

1.1 sigurojë mundësi financimi në kuadër të Buxhetit të Republikës së Kosovës;

1.2 kërkojë mbështetje financiare nga organizmat financiare relevante zhvillimore ndërkombëtare në kuadër të programeve dhe projekteve për promovimin e eficiencës së energjisë;

1.3 propozojë përfshirjen e financimeve për fushën e eficiencës së energjisë në marrëveshjet ndërshtetërore të bashkëpunimit, sa herë që kjo të jetë e mundur.

2. Për mbështetjen e masave për promovimin e eficiencës së energjisë të përcaktuara në Planin Komunal për eficiencën e energjisë, komunat duhet të sigurojnë financim në kuadër të buxheteve komunale ose përmes donacioneve.

3. Sa herë të kërkohet, Ministria do të planifikojë bashkëfinancime buxhetore të fondeve të eficiencës së energjisë që krijohen në kuadër të bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare zhvillimore shumëpalëshe apo dypalëshe.

### **Neni 12** **Auditimi i Energjisë**

Me propozim të ministrisë, Qeveria miraton aktet nënligjore të nevojshme për auditimin e energjisë në përputhje me direktivat e BE-së.

## **KREU V** **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 13** **Zbatimi i Direktivave të BE-së për eficiencën e energjisë**

Ministria paraqet për miratim në Qeveri, akte juridike të veçanta për zbatimin e dispozitave të Direktivave të BE-së, lidhur me eficiencën e energjisë, që dalin nga detyrimet e Republikës së Kosovës si palë e Traktatit të komunitetit të energjisë.

**Neni 14**  
**Dispozitat kalimtare**

Ministria themelon Agjencinë e Kosovës për eficientë e energjisë – AKEE, brenda gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 15**  
**Dispozitat përfundimtare**

1. Me qëllim të zbatimit të këtij ligji, Ministria përgatitë dhe nxjerr akte nënligjore brenda gjashtë (6) muajsh, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Aktet e parashikuara në nenin 13 të këtij ligji do të përgatiten në përputhje me afatet e parashikuara nga vendimet e Këshillit ministror të komunitetit të energjisë.

**Neni 16**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-016**  
**23 qershor 2011**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

\_\_\_\_\_  
**Jakup KRASNIQI**